



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2023-10

**Prokurori i Specializuar kundër Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit
dhe Haxhi Shalës**

Vendosi: Gjykatësja e Procedurës Paraprake

Gjykatëse Marxhori Maselot

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 4 shtator 2024

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Kalimin e Dosjes së Çështjes Gjyqësore Trupit Gjykues I

Trupit Gjykues I

Gjykatës Roland Dekers

Gjykatëse Mapi Feld-Folia

Gjykatës Zhilber Biti

Gjykatës Vladimir Mikula (gjykatës
rezervë)

Prokurores së Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Sabit Januzit

Xhonatan Elistan Ris

Mbrojtjes së Ismet Bahtijari

Felisiti Geri

Mbrojtjes së Haxhi Shalës

Tobi Kadman

GJYKATËSJA E PROCEDURËS PARAPRAKE,¹ në bazë të rregullës 98(1) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL DHE PARASHTRIMET

1. Më 4 tetor 2023, në vijim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,² Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar kundër Sabit Januzit (“z. Januzi”) dhe Ismet Bahtijarit (“z. Bahtijari”).³

2. Më 5 tetor 2023, z. Januzi dhe z. Bahtijari u arrestuan në Kosovë⁴ në përputhje me fletarrestimet e nxjerra nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁵ Të nesërmen, z. Januzi dhe z. Bahtijari u transferuan në objektin e paraburgimit të DHS-së, siç urdhëroi Gjykatësi i Procedurës Paraprake.⁶

¹ KSC-BC-2023-10, F00327 Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 6 qershor 2020, publik.

² KSC-BC-2023-10, F00008, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 2 tetor 2023, rreptësisht konfidencial dhe konfidencial dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik u dorëzuan më 12 tetor 2023, F00008/CONF/RED dhe F00008/RED. Versioni i korrigjuar i versionit të redaktuar publik të vendimit u dorëzua më 12 tetor 2023, F00008/RED/COR.

³ KSC-BC-2023-10, F00010, Prokurori i Specializuar, *Parashtrimi i Aktakuzës së Konfirmuar*, 4 tetor 2023, rreptësisht konfidenciale dhe *ex partë*, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i aktakuzës së konfirmuar dhe Shtojcës u dorëzua më 6 tetor 2023, F00016 dhe F00016/A01.

⁴ KSC-BC-2023-10, F00011, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Ismet Bahtijarit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, publik; F00012, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Sabit Januzit sipas Rregullës 55(4)*, 5 tetor 2023, publik.

⁵ KSC-BC-2023-10, F00009, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Fletarrestime dhe Urdhra Transferimi*, 2 tetor 2023, konfidencial, me Shtojcat 1-4, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik i vendimit u dorëzua më 12 tetor 2023, F00009/RED. Versioni publik me më pak redaktime i vendimit u dorëzua më 3 shtator 2024, F0009/RED/2.

⁶ KSC-BC-2023-10, F00014, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Ismet Bahtijarit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 tetor 2023, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*; F00015, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Sabit Januzit në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 6 tetor 2023, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

3. Më 6 dhjetor 2023, në vijim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake,⁷ ZPS-ja dorëzoi Aktakuzën e Konfirmuar kundër Haxhi Shalës (“z. Shala”).⁸
4. Më 11 dhjetor 2023, z. Shala u arrestua në Kosovë,⁹ në përputhje me fletarrestimin e lëshuar nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.¹⁰ Një ditë më pas, i akuzuari u transferua në objektin e paraburgimit të DHS-së.¹¹
5. Më 8 shkurt 2024, Gjykatësi i Procedurës Paraprake e bashkoi çështjen gjyqësore kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari me çështjen gjyqësore kundër z. Shala (së bashku “të akuzuarit”) (“Vendimi për Bashkimin e Çështjeve”).¹²
6. Më 9 shkurt 2024, duke u bazuar në Vendimin për Bashkimi e Çështjeve dhe në vijim të një versioni të mëparshëm të dorëzuar më 2 shkurt 2024,¹³ ZPS-ja dorëzoi dosjen paraprake të përditësuar.¹⁴

⁷ KSC-BC-2023-11, F00005, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Aktakuzës*, 4 dhjetor 2023, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 janar 2024, F00005/RED.

⁸ KSC-BC-2023-11, F00007, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar*, 6 dhjetor 2023, publik, me Shtojcën 1 rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versionet e redaktuara publike të parashtrimit dhe Shtojcës u dorëzuan më 12 dhjetor 2023, F00013 dhe F00013/A01.

⁹ KSC-BC-2023-11, F00008, Administratorja, *Njoftim i Arrestimit të Haxhi Shalës sipas Rregullës 55(4)*, 11 dhjetor 2023, publik.

¹⁰ KSC-BC-2023-11, F00006, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Lëshimin e Fletarrestimit dhe Urdhrit të Transferimit*, 4 dhjetor 2023, konfidencial, me Shtojcat 1-2, rreptësisht konfidenciale. Versionet e redaktuara publike të parashtrimit dhe të Shtojcave u dorëzua më 28 shkurt 2024, F00006/RED, F00006/A01/RED and F00006/A02/RED.

¹¹ KSC-BC-2023-11, F00011, Administratorja, *Njoftim për Pranimin e Haxhi Shalës në Objektin e Paraburgimit të Dhomave të Specializuara*, 12 dhjetor 2023, publik, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*.

¹² KSC-BC-2023-10, F00161, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Bashkimin e Çështjeve dhe për Ndryshim të Aktakuzës*, 8 shkurt 2024, konfidencial, para. 58(a). Versioni i redaktuar publik i vendimit u dorëzua më të njëjtën ditë, F00161/RED; KSC-BC-2023-11, F00041, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Bashkimin e Çështjeve dhe për Ndryshim të Aktakuzës*, 8 shkurt 2024, konfidencial, para. 58(a). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F00041/RED.

¹³ KSC-BC-2023-10, F00159, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Dosjes Paraprake të Prokurorisë*, 2 shkurt 2024, publik, me Shtojcën 1, konfidenciale.

¹⁴ KSC-BC-2023-10, F00177, Prokurorja e Specializuar, *Parashtrim i Dosjes Paraprake të Prokurorisë, Listës së Dëshmitarëve, Listës së Provave Materiale dhe Tabelës sipas Rregullës 109(c)*, 16 shkurt 2024, publik, me Shtojcat 1- 4, konfidenciale.

7. Më 8 korrik 2024, në vijim të kërkesës së ZPS-së, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi një vendim për ndryshimin e akuzës së frikësimit kundër z. Januzi dhe z. Bahtijari, dhe, ndër të tjera, urdhëroi ZPS-në të dorëzonte një aktakuzë të re të përbashkët të ndryshuar (“Aktakuza e Përbashkët”).¹⁵ ZPS-ja dorëzoi Aktakuzën e Përbashkët më 10 korrik 2024.¹⁶

8. Më 23 korrik 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi “Vendimin mbi Kërkesa të Ndryshme të Mbrojtjes” ku ajo, ndër të tjera, caktoi datën për dorëzimin e dosjeve paraprake të Mbrojtjes: (i) pesë (5) ditë pasi vendimet e Gjykatësës së Procedurës Paraprake mbi mocionin(mocionet) paraprak(paraprake) mbi Aktakuzën e Përbashkët, nëse ka, të bëhen vendime të formës së prerë; dhe/ose (ii) pesë (5) ditë pas vendimit(vendimeve) të Panelit të Gjykatës së Apelit mbi çdo shqyrtim apeli të kërkuar nga palët.¹⁷ Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjithashtu informoi palët se kalimi i dosjes së çështjes gjyqësore Trupit Gjykues parashikohet të bëhet dy (2) ditë pas dorëzimit të dosjes(dosjeve) paraprake të Mbrojtjes, nëse ka, ose pas përfundimit të afateve përkatëse.¹⁸

9. Më 12 gusht 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi një vendim me të cilin rrëzoi mocionet paraprake të Mbrojtjes së z. Januzi (“Mbrojtja e Januzit”) dhe Mbrojtjes së Bahtijarit mbi Aktakuzën e Përbashkët (“Vendimi mbi Mocionet Paraprake”).¹⁹

¹⁵ KSC-BC-2023-10, F00377, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Konfirmimin e Ndryshimeve të Aktakuzës dhe Çështje lidhur me Të*, 8 korrik 2024, konfidencial, para. 79(a)-(c), (g). Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 9 korrik 2024, F00377/RED.

¹⁶ KSC-BC-2023-10, F00379, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Ndryshuar të Konfirmuar*, 10 korrik 2024, publik, me Shtojcat 1-2, konfidenciale, dhe Shtojcat 3-4, publike.

¹⁷ KSC-BC-2023-10, F00406, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesa të Ndryshme të Mbrojtjes* (“Vendimi për Caktimin e Afateve”), 23 korrik 2024, publik, para. 37(a)-(b), dhe 50(b)-(c).

¹⁸ Vendimi për Caktimin e Afateve, para. 45, dhe 50 (e).

¹⁹ KSC-BC-2023-10, F00433, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet Paraprake dhe Kërkesave Lidhur me To*, 12 gusht 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më të njëjtën ditë, F00433/RED. *Shih gjithashtu*, F00399, Mbrojtja e Bahtijarit, *Parashtrim i Bahtijarit mbi Mocionin në Lidhje me Aktakuzën*, 19 korrik 2024, publik; F00402, Mbrojtja e Januzit, *Mocion Paraprak i Januzit*, 19 korrik 2024, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 23 gusht 2024, F00402/RED.

10. Më 19 gusht 2024, në vijim të versionit fillestar të dorëzuar më 19 qershor 2024,²⁰ Mbrojtja e z. Bahtijari ("Mbrojtja e Bahtijarit") dorëzoi dosjen paraprake të rishikuar.²¹
11. Më 23 gusht 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake lëshoi një vendim ku hodhi poshtë kërkesën për leje për apelim të Vendimit mbi Mocionet Paraprake të Mbrojtjes së Januzit ("Vendimi për Leje për Apel").²²
12. Më 26 gusht 2024, Gjykatësja e Procedurës Paraprake rrëzoi: (i) kërkesën urgjente për rishqyrtim të Vendimit për Leje për Apel të dorëzuar nga Mbrojtja e Januzit;²³ dhe (ii) kërkesën për zgjatje të afateve për parashtrimin e dosjes paraprake të dorëzuar nga Mbrojtja e Bahtijarit.²⁴
13. Më 2 shtator 2024, Mbrojtja e z. Shala ("Mbrojtja e Shalës") dhe Mbrojtja e Januzit dorëzuan dosjet e tyre paraprake,²⁵ dhe Mbrojtja e Bahtijarit dorëzoi versionin e përditësuar edhe më tej të dosjes paraprake.²⁶
14. Më 3 shtator 2024, në bazë të rregullës 98(3) të Rregullores, Gjykatësja e Procedurës Paraprake njoftoi Kryetaren se dosja e plotë e çështjes gjyqësore do të jetë

²⁰ KSC-BC-2023-10, F00343, Mbrojtja e Bahtijarit, *Dosja Paraprake e Bahtijarit*, 19 qershor 2024, konfidenciale.

²¹ KSC-BC-2023-10, F00439, Mbrojtja e Bahtijarit, *Dosja Paraprake e Përditësuar e Bahtijarit*, 19 gusht 2024, konfidencial.

²² KSC-BC-2023-10, F00444, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim që Hedh Poshtë Kërkesën për Leje për Apel të Parashtrimit F00433*, 23 gusht 2024, publik. *Shih, gjithashtu*, F00442, *Kërkesë për Leje për Apelimin e Vendimit KSC-BC-2023-10-F00433 në përputhje me nenin 45(2) dhe rregullën 77(1)*, 20 gusht 2024, publik.

²³ KSC-BC-2023-10, F00451, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën për Rishqyrtim të Parashtrimit F00444*, 27 gusht 2024, publik.

²⁴ KSC-BC-2023-10, F00453, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim Lidhur me Afatet për Dorëzimin e Dosjeve Paraprake të Mbrojtjes*, 27 gusht 2024, publik. Versioni i korrigjuar u dorëzua më të njëjtën ditë, F00453/COR.

²⁵ KSC-BC-2023-10, F00457, Mbrojtja e Shalës, *Parashtrim i Dosjes Paraprake të Haxhi Shalës*, 2 shtator 2024, publik, me Shtojcat 1-2, konfidenciale; F00460, Mbrojtja e Januzit, *Dosja Paraprake e Januzit*, 2 shtator 2024, konfidenciale.

²⁶ KSC-BC-2023-10, F00456, Mbrojtja e Bahtijarit, *Dosja Paraprake e Përditësuar edhe Më Tej e Bahtijarit*, 2 shtator 2024, konfidenciale.

gati për t'i kaluar Trupit Gjykses të mërkurën, 4 shtator 2024.²⁷ Të njëjtën ditë, Kryetarja ia caktoi çështjen Trupit Gjykses I.²⁸

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

15. Në bazë të rregullës 98(1) të Rregullores, pas marrjes së dosjeve paraprake përkatëse të ZPS-së dhe të Mbrojtjes, listave të dëshmitarëve dhe listave të provave materiale, sikurse përcaktohet në rregullën 95(4) dhe (5) të Rregullores, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kalon Trupit Gjykses dosjen e plotë të çështjes gjyqësore, e cila përmban:

- (a) Aktakuzën e Konfirmuar;
- (b) të gjitha parashtrimet dhe materialin e dorëzuar nëpërmjet sistemit elektronik të administrimit gjyqësor;
- (c) çfarëdo provash të administruara që nuk përmenden në paragrafin (1)(b);
- (d) çfarëdo letërkëmbimi tjetër në lidhje me çështjen që nuk është dorëzuar në Njësinë e Administrimit të Gjykatës;
- (e) një dokument dorëzues që përfshin:
 - (i) argumentet e palëve dhe, nëse është e zbatueshme, të Mbrojtësit të Viktimave në lidhje me faktet dhe ligjin përkatës;
 - (ii) pikat për të cilat palët pajtohen;
 - (iii) një listë të urdhrave dhe vendimeve të lëshuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake;
 - (iv) provat e paraqitura nga secila palë;

²⁷ KSC-BC-2023-10, F00464, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Njoftim në Përputhje me Rregullën 98(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave*, 3 shtator 2024, publik.

²⁸ KSC-BC-2023-10, F00466, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Trupit Gjykses I*, 3 shtator 2024, publik.

- (v) sugjerime në lidhje me numrin dhe rëndësinë e dëshmitarëve që do të thirren;
 - (vi) pikat e kundërshtuara faktike dhe ligjore;
 - (vii) ecurinë e nxjerrjes së materialeve;
 - (viii) të gjitha mbledhjet me palët; dhe
 - (ix) çfarëdo çështje tjetër të pazgjidhur
- (f) kërkesa dhe vendime në lidhje me nxjerrjen e materialit; dhe
- (g) çfarëdo materiali tjetër që ka lidhje me çështjen.

16. Në bazë të rregullës 98(2) të Rregullores, kalimi i dosjes së çështjes gjyqësore kryhet në mënyrë elektronike.

IV. DISKUTIM

17. Fillimisht, Gjykatësja e Procedurës Paraprake konstaton se janë kryer të gjitha hapat proceduralë të nevojshëm për ta konsideruar dosjen e çështjes gjyqësore KSC-BC-2023-10 të plotë dhe, për rrjedhojë, gati për t'ia kaluar Trupit Gjyqësor I ("Trupi Gjyqësor") në përputhje me rregullën 98 të Rregullores. Gjykatësja e Procedurës Paraprake ka përgatitur gjithashtu një dokument dorëzues që përfshin informacionin e përcaktuar në rregullën 98(1)(e) të Rregullores, për Trupin Gjyqësor dhe palët.

18. Në këtë aspekt, Gjykatësja e Procedurës Paraprake thekson se aspektet e mëposhtme mbeten ende të pazgjidhura në këtë fazë: (i) një kërkesë e Mbrojtjes së Shalës dhe Mbrojtjes së Januzit, për të cilën ende nuk është marrë vendim, lidhur me pranueshmërinë e disa materialeve të nxjerra sipas rregullës 102 të Rregullores;²⁹

²⁹ KSC-BC-2023-10, F00287, Mbrojtja e Shalës, *Kërkesë për Konstatim Papranueshmërie të Materialeve të Nxjerra sipas Rregullës 102 të Rregullores*, 13 maj 2024, konfidenciale. Versioni i redaktuar publik u bë i disponueshëm më 3 korrik 2024, F00287/RED; F00270, Mbrojtja e Januzit, *Kundërpërgjigje ndaj Parashtrimit të Prokurorisë F00266*, konfidenciale; F00285, Mbrojtja e Januzit, *Përditësim lidhur me Kundërshtimin e Provave dhe Nxjerrjen e Materialit*, 13 maj 2024, konfidencial.

(ii) një kërkesë e Mbrojtjes së Januzit, për të cilën ende nuk është marrë vendim, për thirrjen e një dëshmitari;³⁰ (iii) një kërkesë e Mbrojtjes së Bahtijarit, për të cilën ende nuk është marrë vendim, për vlerësim mjekësor të z. Bahtijari;³¹ dhe (iv) një kërkesë e Mbrojtjes së Bahtijarit, për të cilën ende nuk është marrë vendim, për zgjatjen e afateve për dorëzimin e listave të saj të dëshmitarëve.³² Për shkak të natyrës së tyre, Gjykatësja e Procedurës Paraprake gjykon se këto çështje trajtohen më mirë nga Trupi Gjykses dhe, për rrjedhojë, ia kalon ato atij.

19. Nga ana tjetër, duke marrë parasysh zhvillimet në këtë çështje gjyqësore, kërkesat e mëposhtme konsiderohen të tejkaluara: (i) kërkesat e Mbrojtjes së Januzit për një ndërhyrje nga Gjykatësja e Procedurës Paraprake në lidhje me procesin kontraktues për ndihmë juridike lidhur me z. Januzi të përfshira në (a) Shtesën e Kundërpërgjigjes së Januzit ndaj Përgjigjes së Administratores ndaj Përditësimit të Januzit lidhur me Financimin pas Njoftimit të Parashtrimit F00421, (b) Shtesën Tjetër të Kundërpërgjigjes së Januzit ndaj Përgjigjes së Administratores ndaj Përditësimit të Januzit lidhur me Financimin pas Njoftimit të Parashtrimit F00431", dhe (c) Përditësimin e Mëtejshëm të Januzit lidhur me Financimin"³³ ("Kërkesat e Januzit") dhe (ii) Kërkesat e Mbrojtjes së Shalës për financim të përkohshëm urgjent³⁴ si dhe për

³⁰ KSC-BC-2023-10, F00298, Mbrojtja e Januzit, *Kërkesë e Januzit për Thirrjen e një Dëshmitari*, 21 maj 2024, rreptësisht konfidenciale.

³¹ KSC-BC-2023-10, F00273, Mbrojtja e Bahtijarit, *Parashtrim i Bahtijarit për Raporte Mjekësore Ex Parte*, 1 maj 2024, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*.

³² KSC-BC-2023-10, F00461, Mbrojtja e Bahtijarit, *Kërkesë e Bahtijarit për Zgjatje Afati për Listën e Dëshmitarëve*, 2 shtator 2024, konfidenciale.

³³ KSC-BC-2023-10, F00429, Mbrojtja e Januzit, *Shtesë e Kundërpërgjigjes së Januzit ndaj Përgjigjes së Administratores ndaj Përditësimit të Januzit lidhur me Financimin pas Njoftimit të Parashtrimit F00421*, 8 gusht 2024, publike, para. 13; F00434, Mbrojtja e Januzit, *Shtesë Tjetër e Kundërpërgjigjes së Januzit ndaj Përgjigjes së Administratores ndaj Përditësimit të Januzit lidhur me Financimin pas Njoftimit të Parashtrimit F00431*, 9 gusht 2024, publike, para. 9-10; F00435, Mbrojtja e Januzit, *Përditësim i Mëtejshëm i Januzit Lidhur me Financimin*, 14 gusht 2024, konfidencial, para. 2, me Shtojcën 1, konfidenciale. Më 30 gusht 2024, Administratorja informoi Gjykatësen e Procedurës Paraprake se z. Xhonatan Ris nënshkroi kontratën për ndihmë juridike para DHS-së dhe, për rrjedhojë, është caktuar në mënyrë të kushtëzuar si Mbrojtës i z. Januzi, *shih*, F00454, Administratorja, *Njoftim i Caktimit me Kusht të Mbrojtësit dhe Miratim i bashkëmbrojtësit të Sabit Januzit*, 30 gusht 2024, publik, para.5.

³⁴ KSC-BC-2023-10, F00223, Mbrojtja e Shalës, *Kërkesë Urgjente e Haxhi Shalës për Financim të Përkohshëm*, 19 mars 2024, publike. Gjykatësja e Procedurës Paraprake rikujton në atë kontekst se Mbrojtja e Shalës

nxjerrjen e incizimeve audiovizuale të intervistave dhe komunikimeve të tjera me Dëshmitarin 1 dhe W04891-shin të përfshira në (a) Kërkesën e Haxhi Shalës për Nxjerrje të Incizimeve Audiovizuale”, dhe (b) Qartësimin e Kërkesës së Haxhi Shalës për Nxjerrjen e Incizimeve Audiovizuale (së bashku “Kërkesat e Shalës”).³⁵

20. Gjykatësja e Procedurës Paraprake saktëson se, për shkak të informacionit jopublik që përmban, dokumenti dorëzues ka një version të redaktuar konfidencial dhe një version të redaktuar publik në këtë fazë. Dokumenti dorëzues i bashkëlidhet këtij vendimi.

V. VENDIM

21. Për arsyet e lartpërmendura, Gjykatësja e Procedurës Paraprake:

- (i) **I DEKLARON të tejkaluara** Kërkesat e Januzit dhe Kërkesat e Shalës të përmendura në paragrafin 19 më lart; dhe
- (ii) **IA KALON** dosjen e çështjes gjyqësore KSC-BC-2023-10 Trupit Gjykses I, së bashku me dokumentin dorëzues bashkëlidhur këtij vendimi.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Marxhori Masëlo
Gjykatëse e Procedurës Paraprake

E mërkurë, 4 shtator 2024

u udhëzua më 27 mars 2024 të dorëzonte një kërkesë të duhur për ndihmë juridike, të cilën më pas ajo e dorëzoi dhe si rezultat u caktua në mënyrë të kushtëzuar si Mbrojtës i z. Shala (shih KSC-BC-2023-10, F00233, Gjykatësja e Procedurës Paraprake, *Vendim për Caktimin e Kalendarit për Hapat e Mbetur Proceduralë të Fazës Paraprake*, 27 mars 2024, publik, para. 15; F00297, Administratorja, *Përditësim i Administratores Lidhur me Financimin e Ekipeve të Mbrojtjes*, 17 maj 2024, publik, para. 3, 5, me Shtojcat 1-5, konfidenciale dhe *ex parte*).

³⁵ KSC-BC-2023-10, F00263, Mbrojtja e Shalës, *Kërkesë e Haxhi Shalës për Nxjerrje të Incizimeve Audiovizuale*, 24 prill 2024, konfidenciale; F00276, Mbrojtja e Shalës, *Qartësim i Kërkesës së Haxhi Shalës për nxjerrje të Incizimeve Audiovizuale*, 1 maj 2024, konfidencial. ZPS-ja u përgjigj më 7 maj 2024 duke thënë se materiali ishte nxjerrë për Mbrojtjen, shih, KSC-BC-2023-10, F00281, *Përgjigje e Prokurorisë ndaj Parashtrimeve F00263 dhe F00276*, 7 maj 2024, publike.

Në Hagë, Holandë.